Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës ose ftesën për tender*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

² Vetëm për procedurat mbi kufirin e lartë monetar

Shtojca 7

LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial	Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial

KUJDES

Çdo e dhënë, që nuk është regjistruar si e dhënë konfidenciale, do të konsiderohet se titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës dhe Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për publikimin e këtij informacioni.

Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË **Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohe në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij

ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË
Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit³

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Në bazë të parashikimeve të neneve 28 dhe 37 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të Konsulentit “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM Konsulentin “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo konsulenti tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

3. Nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, **me asnjë** nga anëtarët e stafit të autoritetit kontraktor, drejtpërdrejtë ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

³ Kjo deklaratë duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të stafit të konsulentit dhe do të jetë pjesë e dokumentave të ofertës së konsulentit.

Shtojca 10

[Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 11.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, seicili prej anëtarëve të bashkimit duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht⁴;

b. Prokura e posaçme.

⁴ Në këtë marrëveshje nuk duhet të përcaktohet përqindja e shërbimeve të seicilit anëtar, por fushat/ekspertizat e marra përsipër për tu realizuar.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurimin e Ofertës (nese eshte e zbatueshme) sipas Shtojcës 6;
- b. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 8;
- c. Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit, sipas Shtojcës 9;
- ç. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.
- d. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 11/1:

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor),

2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 10).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilanceve, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të mëparshme (**2018, 2019, 2020**).

2.2.2 Vërtetim për deklarimin e xhiros vjetore, lëshuar nga administrata tatimore, ku të vërtetohet se xhiroja mesatare vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit duhet të ketë një vlerë sa 90 % e fondit limit që prokurohet.

2.2.3 Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik. **Vërtetim ky, i marrë jo më parë se 30 ditë nga data e hapjes së ofertave.**

2.2.4 Vërtetim lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin **2019** dhe **2020** për adresën ku operatori ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

Dokumentat standarte të tenderit

Ofertuesit duhet të kenë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet gjate tre viteve te fundit, me vlerë jo më pak se 40 % te vleres se fondit limit . Kjo e vertetuar me:

- Kur ky shërbim është realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur, kontratën e lidhur, ku shenohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe vërtetim të lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate.
ose
- Kur ky shërbim është realizuar me subjekte private operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturën përkatëse tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë liçencë të vlefshme profesionale të shoqërisë për studim e projektim, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore (*sipas modelit të miratuar nga MZHU/MTI*). Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e shërbimeve të kontratës objekt prokurimi, duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- Kat. 1 **c.**
- Kat. 2 **b3,**
- Kat. 3 **a, c1.**
- Kat. 4 **a,**
- Kat. 5 **b, c, e,**
- Kat. 6 **a.**
- Kat. 8 **a, b, c, d, e.**
- Kat. 9 **a, d, e.**
- Kat. 10 **e.**
- Kat. 14

Liçensa duhet të jetë lëshuar sipas rregullave të VKM-së nr. 759, datë 12.11.2014 “*Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*” i ndryshuar me VKM-në nr. 943, datë 28.12.2016.

(Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e liçencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Autoritetit shtetëror kompetent Shqiptar, konform VKM 759, date 12.11.2014, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016)

2.3.3 Operatori ekonomik/ ofertuesi duhet të ketë një punësim jo më pak se **15 (pesëmbëdhjetë) punonjës** në muaj për periudhën, **Shkurt 2020 - Shkurt 2021**, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për vërtetimin e këtij kushti të paraqiten:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

2.3.4 Ofertuesi ekonomik duhet të paraqesë një listë të stafit kryesor (Drejtues Teknik në Licensë të shoqërisë) të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë secilin prej tyre, diplomat, kontratat noteriale te punes dhe Licencen sipas legjislacionit në fuqi si vijon:

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë Drejtues i Ekipit (*Inxhinier ndërtimi ose Hidroteknik*) i cili duhet të jetë pjesë të stafit teknik si drejtues teknik i shoqërisë dhe të figurojë në listëpagesa i punësuar me kohë të plotë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.3. Për përmbushjen e këtij kushti, duhet të paraqiten: Kontrata noteriale e punës, e vlefshme për periudhën e realizimit të shërbimit, Diploma, dhe Liçenca.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhur të stafit drejtues, teknik të shoqërisë, të aftë për kryerjen e të gjitha shërbimeve sipas termave të referencës, për këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë, CV, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë të punësuar me kohë të plotë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.3, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimumi **2 (dy) inxhinier ndërtimi.**
- Minimumi **2 (dy) inxhinier hidroteknik.**
- Minimumi **2 (dy) inxhinier gjeodet.**
- Minimumi **1 (një) arkitekt.**
- Minimumi **1 (një) inxhinier elektrik.**
- Minimumi **2 (dy) inxhinier mekanik.**
- Minimumi **1 (një) inxhinier gjeoteknik.**
- Minimumi **1 (një) inxhinier gjeolog.**
- Minimumi **1 (një) inxhinier mjedisi.**

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- **ISO 9001** (*Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë*) e përditësuar
- **ISO14001** (*Për Menaxhimin e Ambjentit*) e përditësuar
- **OHSAS 18001** (*Për Kushtet e Sigurisë dhe të Shëndetit të Punonjësve*) ose ekuivalente me të e njohur nga standartet shqipëtare, e përditësuar,

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat ISO në përputhje me shërbimet që do të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur me Licence nga Qendra Kombetare e licensimit (QKL) Kodi III.2.A. - *Për auditim mjedisor dhe ndikimin në mjedis.*

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar **1 (një) Ekspert për hartimin e raporteve të ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor**, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të

Dokumentat standarte të tenderit

vlefshme), diplomë, Çertifikatën për ushtrimin e profesionit nga Ministria e Mjedisit, si dhe të figurojë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.3.

2.3.10 Kandidati/ operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë, në pronësi ose me qera, **aparaturë GPS** për punime topografike, minimumi 1 (një) copë. Për këtë të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë, ose kur pajisja është me qera, të paraqitet: kontrata noteriale e qerasë, në përputhje me kohëzgjatjen e kontratës objekt prokurimi, se bashku me dokumentin që vërteton pronësinë e qeradhënësit,.

Shënim: Në përgatitjen e ofertës, ofertuesit duhet të respektojnë përcaktimet e Vendimit nr. 354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e manulit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” dhe Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) me shkresën me Nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017, “Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave” me qëllim respektimin nga operatorët ekonomikë të normave minimale (vlerave minimale të lejuara), të specifikuara në këtë vendim.

Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

- Personi/at në cilësinë e **anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik**, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP⁵.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

⁵ Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë

Dokumentat standarte të tenderit

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shtojca 11/1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE
LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 12

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: **Të kryhet në përputhje të plotë me Termat e Referencës**

Afatet e ekzekutimit: **60 (gjashtëdhjetë) ditë, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

TERMAT E REFERENCËS



BASHKIA MAT

DETYRE PROJEKTIMI

PËR REALIZIMIN E STUDIM PROJEKTIMIT:

**“STUDIM PROJEKTIM I RRJETIT TË KANALIZIMEVE NË ZONAT
PERIFERIKE TË QYTETIT BURREL”**

- NDËRTIMI I IMPIATIT TË PASTRIMIT TË UJRAVE -

Mat 2021

Bashkia Mat, me fond **10.000.000 (dhjetë milion) lekë (me TVSH)** kërkon të realizojë studim projektimin për objektin: **“Studim projektim i rrjetit të kanalizimeve në zonat periferike të qytetit Burrel”** në qytetin e Burrelit, dhe me vlerë paraprake të zërit **Ndërtim - Montim 226.062.000 lekë (me TVSH)**.

OBJEKTI: “STUDIM PROJEKTIM I RRJETIT TË KANALIZIMEVE NË ZONAT PERIFERIKE TË QYTETIT BURREL”

VENDNDODHJA: Qyteti Burrel, Bashkia Mat.

QËLLIMI:

Investimet në rikonstruksionin e rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza të qytetit të Burrelit si dhe disa zonave të fshatrave në periferi të qytetit Burrel, do të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimit, siç është vazhdimësia e shërbimit dhe në uljen e shpenzimeve operative të Ujësjetllës Kanalizime Mat. Bashkia Mat synon të hartojë projekt – zbatimin për ndërhyrjet në rrjetin e ujrave të zeza të zonave periferike të qytetit siç është Lagjia e re (Bajraktari), Lagjia tek repartet ushtarake, SMT-ja deri tek zona e burgut Burrelit, si dhe disa zonave të fshatrave: fshati “Shoshaj”, lagjia “Posum”, lagjia “Kumia e Tullave”, lagjia “Ndrea” dhe zona “ish-baza e asfaltimit” të fshtatit Burrel, gjithashtu do të ndërtohen 4 kolektorët kryesore të qytetit duke kanalizuar për në impiantin e trajtimit të ujrave të zeza të qytetit që do të parashikohet të ndërtohet përpara derdhjes në Lumin Mat. Zona ku do të hartohet projekti i zbatimit aktualisht nuk ka rrjetë të KUZ-ve, dhe përdorin sistemin e gropave individuale septike. Aktualisht me një kërkesë për financim nga Bashkia Mat për rehabilitimin e kësaj zone informale dhe për ndërtimin e impiantit të kanalizimeve të ujrave të zeza të qytetit tek AKUM-i është realizuar fondi për hartimin e projekt – zbatimit për studim projektim i rrjetit të kanalizimeve në zonat periferike të qytetit Burrel dhe ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujrave të ndotura të qytetit.

Nisur nga ky fakt hartimi i projekt zbatimit për studim projektim i rrjetit të kanalizimeve në zonat periferike të qytetit Burrel dhe ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujrave të ndotura të qytetit Burrel merr një rëndësi të veçantë gjithashtu duke konsideruar dhe avancimin e projektit të furnizimit me ujë në qytetin Burrel do t’i hapë rrugë kryerjes së një sërë investimesh infrastrukturorë në qytet dhe në lagjet e fshatrave përreth qytetit.

Mbështetur në strategjinë e zhvillimit për qytetin e Burrelit dhe zonave periferike të tij, si dhe në mundësitë reale për financim nga Bashkia e Matit, hartimi i projektit për rikonstruksionin e rrjetit të kanalizimeve është menduar të hartohet në dy faza:

- 1. FAZA I** përfshin ndërhyrjet në rrjetin e ujrave të zeza të zonave periferike të qytetit siç është lagjia e Re (Bajraktari), lagjia tek Repartet Ushtarake, SMT-ja deri tek zona e Burgut Burrelit si dhe disa zonave të fshatrave përreth qytetit Burrel: fshati “Shoshaj”, lagjia “Posum”, lagjia “Kumia e Tullave”, lagjia “Ndrea” dhe zona “ish-baza e asfaltimit” të fshtatit Burrel.
- 2. FAZA II** përfshin ndërtimin e 4 kolektorëve kryesore të qytetit duke i kanalizuar për në impiantin e trajtimit të ujrave të zeza të qytetit që do të parashikohet të ndërtohet përpara derdhjes në Lumin Mat.

Dokumentat standarte të tenderit

Gjithashtu për shkak të konfiguracionit të terrenit ku shtrihet qyteti i Burrelit, është menduar që të gjithë kolektorët kryesorë të mblidhen në një pikë dhe të transportohen drejt impiantit të ujrave të zeza që sipas diskutimeve paraprake nga ana e Bashkisë Mat është menduar të pozicionohet në afërsi të lumit Mat në Veri – Lindje të qytetit Burrel.


Me planin e mësipërm i jepet zgjidhje përfundimtare problemit të ujrave të zeza të qytetit Burrel, dhe zonave përreth tij, duke siguruar një rrjet kanalizimi të ujrave të zeza tërësisht funksional modern si dhe në përputhje me standartet më të larta të kërkuar, gjithashtu ndahen përfundimisht ujrave të shiut nga ato të zeza në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian. Gjithashtu pasi të përfundojë investimi kostot e mirmbajtjes së drejtorisë së ujësjetës kanalizime Mat do të reduktohen ndjeshëm.

Gjendja e përgjithshme e rrjetit do të përmirësohet, kështu që do të zvogëlohet ndjeshëm numri i nyjeve në tubacion që do të prishen, ndaj do të zvogëlohen të gjitha kostot që lidhen me to.

PËRSHKRIMI I SHKURTËR I GJENDJES:


Rrjeti ekzistues i rrethinave të qytetit është në gjendje të amortizuar dhe thuajse inekzistent, gjithashtu në pjesë të tij funksionon me gropa septike duke u bërë problem infeksionesh për banorët.

Më poshtë paraqitet harta e shtrirjes së zonës së projektit për ndërhyrjet në rrjetin e ujrave të zeza të zonave periferike të qytetit siç është lagjia e Re (Bajraktari), lagjia tek Repartet Ushtarake, SMT-ja deri tek zona e Burgut Burrelit si dhe ndërtimi i 4 kolektorëve kryesorë të qytetit:



Harta Nr.1

Zonat e trajtimit sipas hartës Nr. 2 do të jene vazhdimi lagjes “Re”, Lagja “Zall Shoshaj”, lagjja “Shoshaj”, lagja “Kumia e Tulles”, lagjja “Posum” lagjja “Ndrea” dhe zona “ish-baza e asfaltimit” të fshatit Burrel, për të cilat do të shikohet mundësia e zgjidhjes me gropa septike



Harta Nr.2

Popullsia e qytetit të Burrelit është rreth 16,575 banorë rezidentë dhe jo-rezidentë për arsye të lëvizjes së popullsisë në emigracion. Gjatë kohës së verës popullsia rritet në krahasim me stinët e tjera si rezultat i ardhjes së popullsisë emigratore dhe plotëson numrin maksimal të saj.


Ky koeficient rritje është i justifikuar sepse perspektiva e zgjerimit të zonës së banimit parashikohet të bëhet me vila individuale të cilat do të kenë numër më të madh banorësh rezident dhe sezonale dhe normë më të lartë ditore të përdorimit të ujit. Në stinën e verës konsumi i ujit rritet në krahasim me stinën e dimrit.


Konsumatorë të tjerë janë lokalet e shërbimit me konsum uji të vogël. Numri i këtyre konsumatoreve do të llogaritet sipas sipërfaqes nga 50 -100 m² për bar-kafe dhe 100 deri 350 m² për bar - restorante. Për objektet e prodhimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore dhe industriale do të llogariten nevojat e furnizimit me ujë sipas kapacitetit të tyre të prodhimit dhe të

Dokumentat standarte të tenderit

konsumit të ujit të pijshëm në sasira minimale si dhe nevoja për shkarkim ujrash të zeza. Për objekte me kapacitete relativisht të mëdha prodhimi dhe konsumi i madh të ujit të pijshëm furnizimi i tyre do të mundësohet vetëm nga shtimi i burimeve të jashtme të ujësjellësit.

Seksionet tipe për përdorim në hartimin e projekt zbatimit:





OBJEKTIVI:

Objekтиви i detyrës së projektimit është hartimi i projektit të zbatimit “**STUDIM PROJEKTIM I RRJETIT TË KANALIZIMEVE NË ZONAT PERIFERIKE TË QYTETIT BURREL**” DHE NDËRTIMI I IMPIATIT TË PASTRIMIT TË UJRAVE” -, Bashkia Mat.

QËLLIMI I PUNËS:

Për realizimin e projektit, projektuesi duhet të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me projektin që duhet të hartojë për rikonstruksionin e magjistralit sekondar dhe terciar të shkarkimit të ujrave të zeza sipas detyrës së projektimit dhe të konsultohet me njësinë e qeverisjes vendore, “Ujësjellës Mat” Sh.a., “OSHEE” Sh.a, dhe Telekomin.

Cilësia e studim projektimit duhet të jetë e tillë që të arrihet standarti i kërkuar dhe të plotësojë kushtet e projektimit.

TË DHËNAT PËR PROJEKTIN:

1. Popullsia aktuale është 16,575 banorë.
2. Prespektiva e rrjetit të kanalizimeve të parashikohet për 20 - 25 vjet.
3. Norma e furnizimit me ujë të jetë 150 litra ujë/ditë për banor.
4. Materiali i tubacionit të jetë HDPE SN 8 diametra të ndryshëm.
5. Planimetria e rrjetit ekzistues.

KËRKESAT QË DUHET TË ZGJIDHË PROJEKTI:

Projekti i hartuar duhet të përmbajë :

1. Korografinë në shkallë 1:25000
2. Planimetrinë e rrjetit në shkallë 1:1000; 1:5000.
3. Profilin gjatësor në shkallë H 1:1000; V 1:500 .
4. Profila tërthorë në shkallë 1:20.
5. Detaje të ndryshme në shkallë 1:50 .
6. Planimetri, prerje, detaje të ndërtimit të depove.
7. Relacioni teknik për zgjedhjen e dhënë sipas detyrës së projektimit.
8. Llogaritjet hidraulike të impiantit dhe rrjetit.
9. Llogaritjet konstruktive të impiantit.
10. Përshkrimi i gjendjes së trasesë.
11. Preventivi i kryerjes së punimeve, duke u mbështetur në çmimet e Manualit të Çmimeve të vitit 2015 të shoqëruara me analizat përkatëse.
12. Specifikimet teknike të zbatimit të projektit .
13. Projekt preventivi të paraqitet në tre kopje dhe në formë dixhitale.
14. Raport i Vlerësimit Mjedisor
15. Grafiku punimeve
16. Raporti topografik.
17. Studimi hidrologjik
18. Studimi gjeologjik – inxhinierik
19. Oponence teknike
20. Studimi gjeoteknik
21. Detaje të tjera

TË DHËNAT KRYESORE:

Bashkia Mat, me fondin 10.000.000 lekë (me TVSH) kërkon të realizojë studim projektimin për objektin: “Studim projektim i rrjetit të kanalizimeve në zonat periferike të qytetit Burrel” në qytetin e Burrelit dhe zonave periferike, dhe me vlerë paraprake të zërit Ndërtim - Montim 226.062.000 lekë (me TVSH), bazuar në programin e investimeve për vitin 2021, të Bashkisë Mat.

INVESTIMI THEMELOR LLOGARITUR SIPAS PREVENTIVAVE PARAPRAK

Investimi themelor (vlera paraprake e investimit) është 226.062.000 lekë me TVSH.

VLERA PËR PROJEKTIM SIPAS VLERES PARAPRAKE TË INVESTIMIT LLOGARITUR SIPAS V.K.M, VKM Nr. 354, datë 11.05.2016.

Vlera për projektim për vlerën paraprake të investimit është 10.000.000 lekë me TVSH.

Dokumentat standarte të tenderit

Për llogaritjen e vlerës së projekteve sipas VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 janë marrë vetëm fazat V-VI Seksioni i Veprave Inxhinierike të VKM-së Nr. 354, datë 11.05.2016, grupi tarifor III.

Mënyra e Pagesës

Konsulenti do të paguhet pasi të dorëzojë materialin e kërkuar në Detyrat e Projektimit dhe pasi të merret në dorëzim nga Bashkia Mat. Pagesa do të kryhet sipas Nenit 15 të VKM-së 354.

Preventivi Paraprak për llogaritjen e vlerës paraprake të investimit është hartuar nga Drejtoria e Urbanistikës dhe Infrastrukturës të Bashkisë Mat.

Stafi që kërkohet:

- Inxhinier hidroteknik;
- Inxhinier ndërtimi;
- Inxhinier topograf;
- Inxhinier elektrik;
- Inxhinier Mekanik;
- Inxhinier Gjeolog Gjeoteknik;
- Inxhinier Mjedisi;
- Staf mbështetës për fushat e mësipërme.

Dorëzimi i dokumentacionit

Produkti	Nr. i kopjeve	Afati i dorëzimit
Faza I-II-IV-V-VI e Projektit Dokumentat e projekt zbatimit përfshirë Vizatimet, Raportet, Grafikun e Punimeve, Specifikimet dhe Preventivin	3 shqip + kopje elektronike	60 ditë pas fillimit të kontratës

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁶

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u skualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

⁶ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

* * *

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Etj.

* * *

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Dokumentat standarte të tenderit

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Etj.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri, Nipti dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me _____ pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 49 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Dokumentat standarte të tenderit

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj.____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 19

KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES Shërbimet e Konsulencës

Neni 1 Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për Shërbimet e Konsulencës.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
